



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/13  
Datë: 13.07.2020

Në mbështetje të nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në zbatim të nenit 89 dhe nenit 90 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi si dhe në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11 datë 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. **Obligohen** të gjithë banorët e Republikës së Kosovës të bartin maskat për fytyrë në të gjitha aktivitetet jashtë shtëpive/banesave të tyre, si dhe të mbajnë distancë fizike prej 2m në ambiente të përbashkëta jashtë shtëpive/banesave të tyre (obligohen institucionet punëdhënëse të krijojnë kushte që në ambiente pune kjo distancë të aplikohet);
2. **Obligohen** të gjithë institucionet publike dhe private të mbajnë dezinfektantë për duar dhe maska për fytyrë në vende të qasshëm, në hyrje të objektit, të cilat mund të shfrytëzohen nga punëtorët e institucioneve dhe vizitorët;
3. **Obligohen** organet kompetente të ushtrojnë kontroll rigoroz me qëllim të zbatimit të masave (Inspektoratet relevante dhe organet e rendit);
4. **Obligohen** institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjti vlen deri në një vendim tjetër.

**A r s y e t i m**

Meqenëse në ditët e fundit ka rritje të rasteve të prekura me COVID-19, kjo mund të shpie në përhapje masive të virusit, që do të rrezikon seriozisht shëndetin publik me pasoja të rënda për shëndetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/13

Datë: 13.07.2020

Në mbështetje të nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në zbatim të nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi si dhe në zbatim të dispozitave të nenit 41, neni 50 të Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, duke bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11 datë 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, pas diskutimit me njësitë përkatëse në zbatim të rekomandimit të IKShPK-së, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Nga data 13 korrik 2020, duke filluar nga ora 21:00 deri në orën 05:00, ndalohej çfarëdo qarkullimi i personave fizikë jashtë shtëpive/banesave të tyre në Komunat: Mitrovicë e Jugut, Gjilan, Fushë Kosovë dhe Shtërpçë, përveç:
  - 1.1. Në raste urgjente shëndetësore;
  - 1.2. Në rast të nevojës për t'u kujdesur për të sëmurë, për persona me nevoja të veçanta, vetëm nëse të sëmurët apo personat me nevoja të veçanta nuk kanë mundësi të kujdesen për vetveten;
  - 1.3. Në rast të kërkimit të ndihmës nga institucione përkatëse, siç është rasti me viktimat e dhunës familjare;
  - 1.4. Në rast të vdekjes së anëtarit të familjes;
  - 1.5. Në rast të paraqitjes së nevojave për dalje jashtë shtëpisë/banesës për nevojat fiziologjike të kafshëve, por jo më larg se 500 metra nga banesa/shtëpia (por, nuk lejohet shfrytëzimi i këtyre rasteve për të kryer ndonjë punë tjetër ose për ndonjë qëllim tjetër përveç atij të përcaktuar).
2. Obligohen institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjti vlen deri në një vendim tjetër.

**A r s y e t i m**

Meqenëse në ditët e fundit ka rritje të rasteve të prekura me COVID-19, në komunat përkatëse, kjo mund të shpie në përhapje masive të virusit, që do të rrezikon seriozisht shëndetin publik me pasoja të rënda për shëndetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Avdullah HOTI

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/13

Datë: 13.07.2020

Në mbështetje të nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në zbatim të nenit 89 dhe nenit 90 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi si dhe në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/11 datë 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, në zbatim të paragrafit 3 të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/10, datë 05.07.2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Autorizohet Ministri i Shëndetësisë për plotësimin e Udhëzimit Administrativ 09/2014 – Kushtet për punë sa i përket hapësirës, kuadrit profesional dhe pajisjeve medicinale të institucioneve private dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2015 Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta spitalore, duke tejkualuar të gjitha procedurat që përcaktohen me Rregulloren Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 13/2013 për shërbimin ligjor qeveritar;
2. Plotësim ndryshimi i këtij akti nënligjor përfshin vetëm përcaktimin e kushteve/kritereve specifike për të kryer testime molekulare dhe serologjike për Covid -19;
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Duke iu referuar kërkesave në rritje për testim për COVID 19 në Kosovë si dhe kapaciteteve të limituara të IKShPK-së për diagnostikë molekulare dhe serologjike për COVID 19, me qëllim që ky shërbim të jetë sa më i qasshëm për qytetarët e Kosovës, IKShPK rekomandon Ministrinë e Shëndetësisë që t'iu ofroj mundësinë edhe institucioneve tjera shëndetësore publike dhe private në Kosovë të testojnë për prani të acideve nukleike të SARS-CoV-2, antigjeneve të SARS-CoV 2 ose të antitropave ndaj SARS-CoV 2, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/13

Datë: 13.07.2020

Në mbështetje të nenit 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në zbatim të nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi si dhe në zbatim të dispozitave të nenit 41 dhe nenit 50 të Ligjit nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11 datë 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, pas diskutimit me njësitë përkatëse në zbatim të rekomandimit të IKShPK-së, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 korrik 2020, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV), Malit të Zi, dhe Bosnje e Hercegovinës (BeH) që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës (RKS) duhet të dëshmojnë se nuk vuajnë nga COVID-19, me anë të vërtetimit që dëshmon testin RT-PCR negativ në Sars COV-2, jo më të vjetër se 72 orë nga koha kur paraqiten në kufirin e RKS,
  - 1.1. Qytetarët e këtyre vendeve gjatë hyrjes përmes pikave kufitare ajrore, Aeroportit Ndërkombëtar "Adem Jashari" nuk kanë nevojë të prezantojnë vërtetimin për test RT-PCR, duke marrë parasysh që shtetasit e këtyre vendeve vetëm do të kalojnë tranzit përmes territorit të Republikës së Kosovës, me kusht që në hyrje do të nënshkruajnë një deklaratë ku deklarohen se në afat prej 3 orëve do ta lëshojnë territorin e RKS-së;
  - 1.2. Qytetarët e këtyre vendeve gjatë hyrjes në pikat kufitare tokësore, me qëllim të daljes nëpër pikat ajrore, nga Aeroporti Ndërkombëtar "Adem Jashari" nuk kanë nevojë të prezantojnë vërtetimin për test RT-PCR, por shtetasit e këtyre vendeve janë të obliguar të paraqesin biletën e aeroplanit dhe të nënshkruajnë një deklaratë ku deklarohen që brenda 3 orëve do ta lëshojnë territorin e RKS-së;
  - 1.3. Transportuesit profesionistë (vozitësi) që vijnë nga këto vende nuk është e nevojshme të prezantojnë vërtetimin për testin RT-PCR, por janë të detyruar të respektojnë protokollet për transport ndërkombëtar;
  - 1.4. Për transport të organizuar me autobusë ose linja të rregullta ndërkombëtare në transit nga këto vende, nuk duhet të prezantohet vërtetimi për testin RT-PCR, por duhet të nënshkruhet një deklaratë nga ana e tyre me të cilën obligohen të lëshojnë territorin e RKS-së brenda 5 orëve;
  - 1.5. Shtetasit e Malit të Zi, RVM dhe BeH që kanë të rregulluar leje qëndrimin e përkohshëm ose të përhershëm në RKS, gjatë hyrjes në RKS duhet të prezantojnë vërtetim për test RT-PCR negativ, të bërë më së largu 72 orë para hyrjes në RKS;


- 1.6. Diplomatët e huaj nga shtetet e lartcekura në këtë vendim, që janë të akredituar në RKS, si edhe familjarët e tyre **nuk është e nevojshme të prezantojnë vërtetimin për test RT-PCR;**
- 1.7. Shtetasit e Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi dhe Bosnje e Hercegovinës të cilët kanë të caktuar termine për mjekim në institucione shëndetësore të RKS-së, **duhet të prezantojnë vërtetimin për test RT-PCR negativ, të bërë më së largu 72 orë para hyrjes në RKS si dhe vërtetimin për termin të caktuar, të lëshuar nga institucioni shëndetësor;**
- 1.8. Shtetasit e Malit të Zi, RMV dhe Bosnje e Hercegovinës, të cilët kanë dy shtetësi, nëse kanë vendbanim në Kosovë (sipas evidencës së MAP ose kanë letërnjoftim të RKS) **nuk është e nevojshme të kenë vërtetim për test RT-PCR;**
- 1.9. Bartësit e dokumenteve personale të lëshuara nga RKS mirëpo me adresë vendbanimi në njërin nga shtetet e cekura në këtë vendim, gjatë hyrjes në RKS **duhet të prezantojnë vërtetimin për test RT-PCR negativ, të bërë më së largu 72 orë para hyrjes në RKS.**
2. Pezullohet veprimtaria e çerdheve në Institucionet publike dhe private (me kusht që njëri prind të lirohet nga puna për kujdes ndaj fëmijëve që janë nën moshën 10 vjeçare);
3. Pezullohen aktivitetet rekreative, kulturore dhe sportive të mbyllura në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës (përfshirë fitneset, pishinat, shkollat e futbollit dhe sporteve tjera, trajnimet e kësaj lëmie etj). Të gjitha aktivitetet e lartcekura që zhvillohen në ambiente të hapura detyrohen të zbatojnë në përpikëri kushtet e parapara në Manualin për mbrojtje nga COVID-19;
4. Obligohen të gjitha qendrat tregtare në territorin e Republikës së Kosovës të ushtrojnë veprimtaritë tregtare prej orës 05:00 të mëngjesit deri në orën 21:00, duke zbatuar në përpikëri kushtet sipas Manualit për mbrojtje nga COVID-19, e mbi të gjitha mbajtjen e detyruar të maskave dhe krijimin e kushteve për distancë fizike të konsumatorëve;
5. Pezullohet puna në tregjet publike të automjeteve dhe tregjet e kafshëve, në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës;
6. Pezullohen ceremonitë fetare në Institucionet fetare në Republikën e Kosovës;
7. **Ndalohet grumbullimi i qytetarëve më shumë se 5 persona në sheshet publike, parqe dhe të ngjashme;**
8. **Obligohen operatorët e shërbimeve komunale, financiare, elektronike dhe postare të ofrojnë shërbime me orar dhe staf minimal, sipas masave në fuqi për emergjencën në shëndetin publik;**
9. Qytetarët e moshuar (mbi moshën 65 vjeç) dhe qytetarët me sëmundje kronike (diabet, hipertensioni arterial dhe sëmundje zemre, sëmundje kronike të mushkërive, pacientët me sëmundje të veshkave, pacientët me imunitet të suprimuar, pacientët onkologjikë etj) mund të dalin jashtë në ambiente publike vetëm në orët e hershme të mëngjesit (prej orës 05:00 deri në orën 10:00) dhe orët e mbrëmjes (prej orës 18:00 deri në orën 21:00);
10. **Obligohen të gjithë banorët e Republikës së Kosovës të zbatojnë masat parandaluese dhe rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe Ministrisë së Shëndetësisë të lëshuara në Manualin për mbrojtje nga COVID-19.**

11. Obligohen organet kompetente të ushtrojnë kontroll rigoroz me qëllim të zbatimit të masave (Inspektoratet relevante dhe organet e rendit);
12. Obligohen institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
13. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjti vlen deri në një vendim tjetër.

### **A r s y e t i m**

Meqenëse në ditët e fundit ka rritje të rasteve të prekura me COVID-19, kjo mund të shpie në përhapje masive të virusit, që do të rrezikon seriozisht shëndetin publik me pasoja të rënda për shëndetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe duke pasur parasysh situatën epidemiologjike të përkeqësuar në Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi javët e fundit, kërkojmë që qytetarët e dy shteteve fqinje me rastin e hyrjes në territorin e Kosovës duhet të dëshmojnë se nuk janë të sëmurë me COVID-19, me anë të dëshmisë TESTI NEGATIV në RT-PCR në SARS CoV-2, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Avdullah HOTI**



\_\_\_\_\_  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë